



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 58, Datë 29.10.2007

**“PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS PËR SIPËRFAQEN 516 m2 (OBJEKT I DREJTORISE Nr. 3 TE QYTETIT) DHE REFLEKTIMIN NË LISTËN E PJESSHME TË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË CILAT JANË NË TËRRITORIN NËN JURIDIKSIONIN E BASHKISË SË TIRANES”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore“, neni 32 pika e, Ligjit Nr.7661 datë 19.01.1993. “Për Kontabilitetin”, Vendimit Nr.150 datë 23.01.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Heqjen nga Lista e Inventarit të Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit të sipërfaqes 516 m2, sipas hartës së bashkëlidhur.
2. Reflektimi i këtij ndryshimi në Listën e Pjesëshme të Inventarit të Pronave të Paluajtshme të cilat janë në territorin, nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria nr.3 e Punëtorëve të Qytetit dhe Drejtoria e Administrimit të Aseteve.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sokol DERVISHAJ**

**K R Y E T A R**